

VENDIM
Nr.138, datë 11.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS
“ISUF SOKOLI”, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Isuf Sokoli”, në bashkinë e Shkodrës.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 456.2 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) m², tokë/truall, dhe 434.34 (katërqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e katër) m² ndërtesë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 14 264 814 (katërmbydhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e katërmbydhjetë) lekë.

3. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen po nga bashkia e Shkodrës.

5. Shpronësimi të përfundojë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa rikonstruksioni i rrugës të përfundojë brenda afateve të parashikuara nga bashkia e Shkodrës.

6. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës dhe regjistrimi i pasurisë, 456.2 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) m², tokë/truall, dhe 434.34 (katërqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e katër) m² ndërtesë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Shkodrës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

8. Bashkia e Shkodrës të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS “ISUF SOKOLI” NË BASHKINË SHKODËR

[illegible]